



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/187
Datë: 31.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 2. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare dhe kontraktuale nga viti paraprak.
- Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe ministrinë e ndikuara, për zbatimin e këtij Vendimi.
- Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me Tabelat nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës për informim.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/187
Datë: 31.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Pasqyra Preliminare Financiare për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Bilancin e Fondeve për vitin 2023.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Pasqyrën nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 9. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë